**K R Y E T A R I**

Nr._______ prot. Kavajë, më___, ___, 2025

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim

**Z. Rudin Hylviu**
**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIA KAVAJË**

**I nderuar zoti Kryetar,**
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues,:

**"PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE PASURIA ME NR. 267/26, LLOJI PASURISË ARË, ME SIPËRFAQE 9000 M2, ME INDEKS HARTE KJ-34-100-(50-C) , ZK 2291, PASURI NË PRONESI TË BASHKISË KAVAJË, E REGJISTRUAR NË ASHK KAVAJË.**

Me respekt,

**K R Y E T A R I**
**Fisnik Qosja**
**Miratoi:**

**Arti Çiçolli** : Sekretari i Përgjithshëm

Datë: _______

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (dy)

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 4 (katër)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAVAJË**

Kavaje me ____.____ 2025

**PROJEKT-VENDIM**
**Datë ___/___/ 2025**

**"PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE PASURIA ME NR. 267/26, LLOJI PASURISË ARË, ME SIPËRFAQE 9000 M2, ME INDEKS HARTE KJ-34-100-(50-C) , ZK 2291, PASURI E REGJISTRUAR NË ASHK, NË PRONESI TË BASHKISË KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja "a", "c", nenit 18 pika 2, nenit 54, shkronja "e/1", nenit 55 pika 4, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, të Vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimit Nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", i ndryshuar, VKM nr. 370, date 30.01.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Golem të qarkut të Tiranës", shkresës së sjellë nga DAMT me nr. 1111/1 prot date 24.11.2022 Kryetari i Bashkisë Kavajë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të rradhës:

**TË VENDOSË:**

1. Të miratojë dhënien me qira të tokës bujqësore për pasurinë nr. 267/26, lloji pasurisë are, me sipërfaqe 9000 m2, me indeks harte Kj-34-100-(50-C), ZK 2291 Kryemedhenj Njesia Administrative Golem
2. Afati për dhënien me qera do të jetë në përputhje me parashikimet e kreut IV të Udhëimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" i ndryshuar, në varësi të kulturave bujqësore për të cilat do të merret me qira kjo pasuri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Kadastres Urbane, Menaxhimit te Aseteve Publike, Drejtoria e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij projektvendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

**Sekretari i përgjithshëm**
**Arti Çiçolli**

**Drejtoria e Burimeve Ekonomike**
**Andi Çurgu**

**Drejtoria Ligjore**
**Adrian Malaj**

**Sekretare e Keshillit Bashkiak**
**Meri Biturku**

**KRYETAR I BASHKISË**
**FISNIK QOSJA**

# RELACION

**Për miratimin e dhënies me qira të tokës bujqësore pasuria me nr.267/26, lloji pasurisë Arë, me sipërfaqe 9000 m2, me indeks harte Kj-34-100-(50-C) , ZK 2291, pasuri e regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë Kavajë**

Bashkia Kavajë ashtu si shumë bashki të tjera, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e saj, i ushtron në zbatim të *Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.*

Në pikën 2 të nenit 27 të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, për funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, bashkitë janë përgjegjëse edhe për administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.

Në Udhëzimin Nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", i ndryshuar, përcaktohen qartë procedurat, kriteret dhe tarifat për të cilën toka bujqësore jepet me qira apo efiteoze tek të tretët, duke iu nënshtruar procedurave të konkurrimit publik për dhënien me qira të kësaj pasurie.

Afati për dhënien me qera do të jetë në përputhje me parashikimet e kreut IV të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" i ndryshuar, në varësi të kulturave bujqësore për të cilat do të merret me qira kjo pasuri.

Pasuria objekt i dhënies me qira është toka bujqësore në zërin kadastral arë, të miratuara edhe në listën e pronave që i transferohen në pronësi apo përdorim Bashkisë Kavajë, VKM nr. 370, date 30.01.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Golem të qarkut të Tiranës" një ndër pasuritë që bën pjesë në inventarin e këtyre pronave eshte dhe pasuria 267/26, lloji pasurisë are, me sipërfaqe 9000 m2, me indeks harte Kj-34-100-(50-C), ZK 2291 në kryemedhenj Njesia Administrative Golem ,e regjistruar në ASHK.

Bashkia Kavajë do ndjekë të gjitha procedurat për dhënien me qira të kësaj parcele pasi edhe vetë vendndodhja e saj është e përshtatshme për kultivimin e pemëve drufrutore, vreshtari por edhe ullishte.

Gjithashtu ju sqarojmë se edhe raportet e KLSH orientojnë Bashkinë Kavajë për shfrytëzimin e aseteve që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Kavajë dhe i ka konsideruar si të ardhura të munguara.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja "a", "c", nenit 18 pika 2, nenit 54, shkronja "e/1", nenit 55 pika 4, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, të Vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimit Nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", i ndryshuar, VKM nr. 370, date 30.01.2013 "Për miratimin

e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Golem të qarkut të Tiranës", shkreses se sjelle nga DAMT me nr. 1111/1 prot date 24.11.2022 Kryetari i Bashkisë Kavajë i propozon

Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të rradhës të miratojë dhënien me qira të tokës bujqësore për pasurinë nr. 267/26, lloji pasurisë kryemedhenj Njesia Administrative Golem.

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHEM**
**ARTI ÇIÇOLLI**

SHQIPËRISË
TARIA
KAVAJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT TIRANË**
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS**

Nr. 1111/1 prot.  Tiranë, më 29.11.2022

Lënda: Kthim përgjigje

**DREJTORISË SË KADASTRËS URBANE MENAXHIMIT TË ASETEVE PUBLIKE**
**BASHKISË KAVAJË**

Në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) pranë Këshillit të Qarkut Tiranë është administruar shkresa Juaj me **nr.3933prot., datë 17.11.2022** me të cilën **keni kërkuar konfirmimin e zërit kadastral dhe kategorizimin sipas bonitetit** për pasurinë më nr.267/26 zk 2291 fshati Kryemëdhenj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Kavajë.

Bazuar në ligjin nr.8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar dhe në VKM nr.121, datë 17.02.2011 "Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna dhe/ose Bashki", ju bëjmë me dije se:

Pasuria me nr.267/26 zk2291, mbivendoset në parcelën me nr.267 me zërin kadastral-**"Arë"**, gjëndja deri me 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcela është e bonituar, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë ,parcela rezulton me këto të dhëna:
  Parcela me nr.267/26- 56.28.Ball, Kategoria V sipas bonitetit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**DREJTOR**
**Mersin MURATAJ**

Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Ataturk", Tel. (04)42225141, Fax. (04)42223890, e-mail: kryetari@qarkutirane.gov.al


REZERVUARI TILAJ
K.B. KRYEMDHEJ

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

## KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2291047093
(Nga 2291005102 , Në ____)

### A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2291 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 267/26 , Sipërfaqja Totale 9000 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-100-(50-C) , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia KRYEMEDHENJ , Rruga ______ , Ndërtesa Nr. ___ , SH/K ___ , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 001422 , Dt. 29/09/2022), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

### B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA KAVAJE , Nr. Identifikimi/NIPT K52903801C , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia - , Rruga LAGJA 1 , Ndërtesa Nr. - , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme , Nr. 001422 , Datë: 29/09/2022
Regjistruar: Nr. 00017422 , Datë: 29/09/2022

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr.____, me Kod Unik ____*

### B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA
SEKR
BASHKI

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

## KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

### C-TË DREJTAT REALE

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i të Drejtës | Të Dhënat e Aktit | | | Afati i Vlefshmërisë | Përfitues | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Emërtim | Nr. | Datë | | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/ NIPT |
| 00017426 | 29/09/2022 | | Dhene ne perdorim Bashkise Kavaje ne baze te V.K.M 370. dt. 30.01.2013 Bllokuar | | | 0 | | |

### D - KUFIZIMET E PRONËSISË

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i Kufizimit | Të Dhënat e Aktit | | | Afati i Kufizimit | Përfitues/Kërkues | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Emërtim | Nr. | Datë | | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/ NIPT |
| | | | | | | | | |

### E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi:

**DREJTORI**
**Ariona Stamo**

Ariona Stamo

Digitally signed by: Ariona Stamo
Date: 2022.09.29 03:00:51 +02'00'

**Data e lëshimit 29/09/2022**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS KAVAJË DREJTORIA VENDORE

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Kavajë
Date:2022/09/29 11:11:06 +02'00'
K52903801C2022092911105991ASHK

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

# FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

**ZONA KADASTRALE:** 2281

**KODI UNIK:** ______

**NUMRI PASURISË :** 267/26

**INDEX I HARTËS:** K-34-100-(50-C-D)

**KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE**




Ariona Stamo

Digitally signed by Ariona Stamo
Date: 2022.09.29 03:01:33 +02'00'

**SH 1:** ______

**DREJTORI**

Data e leshimit __/__/____

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Kavajë
Date:2022/09/29 15:02:03 +02'00'
K52903801C2022092915014080014

**SHPJEGUES**

PARCELA

NDERTESA

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Kavajë)*